



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/04, qershor 2008), të nenit 7, pika 1.3.1 dhe pika 1.3.2 të Ligjit nr. 06/L-012, për kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10/06 qershor 2018") dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 05.06.2019, merr këtë

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE "KUZHINA QENDRORE" SHA

I.

MIRATOHET Vendimi për themelimin e ndërmarrjes publike lokale "Kuzhina Qendrore", SHA, Prishtinë.

II.

Ndërmarrja publike lokale si në pikën I, themelohet me qëllim të furnizimit me ushqim të kopshteve, institucioneve arsimore dhe nevojave të tjera.

III.

Ndërmarrja e cekur në pikën I të këtij Vendimi është:

1. Shoqëri aksionare, me aksionet e Komunës së Prishtinës;
2. Kapitali themeltar për funksionimin normal të NPL "Kuzhina Qendrore", do të jetë në shumën prej dhjetë mijë euro (10,000 €);
3. Selia kryesore e kësaj ndërmarrje është në territorin e komunës së Prishtinës;
4. Përgjegjës për drejtimin e ndërmarrjes janë: Komisioni i Aksionarëve, Bordi i drejtorëve dhe menaxhmenti.

IV.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i biznesit dhe Analiza financiare e NPL “Kuzhina Qendrore”, SHA.

V.

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-030/01-129433/19, më 06.06.2019

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

